



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vucitrn – Municipality of Vushtrri



Drejtoria për Arsim

10 Nr. *706* /26
Vushtrri, më *04.09.2026*

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 13, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, datë 12.01.2016, Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri shpall:

FTESE PËR OFERTË

Për organizimin e Ekskursionit në Shqipëri me maturantët e shkollave:

1. SHMP "Bahri Haxha" Vushtrri
2. SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtrri dhe
3. Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri

Ekskursioni do të zgjatë katër bujtje e pesë ditë, gjatë muajit shtator, tetor 2026

Agjencioni duhet t'i plotësojë këto kushte:

1. Duhet të jetë i licencuar
2. Duhet të ketë Certifikatë Transportuese
3. Dëshmitë e kontrollit të autobusëve
4. Duhet të siguroj përkujdesje mjekësore (Certifikat pune dhe diplomë të mjekut)
5. Vendi-hoteli i vendosjes, sipas datave dhe konfirmimin
6. Numri i nxënësve të vendosur nëpër dhoma
7. Personi kontaktues në hotel- adresa dhe nr. telefonit
8. Autobusët të jenë komfor dhe me klimë
9. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve
10. Agjencionet të cilat kanë referenca negative nga DKA nuk do të hapen
11. Agjencioni duhet t'i mbulojë shpenzimet e kujdestarëve të klasave dhe shpenzimet e nxënësve në vizitat të monumenteve historike
12. Agjencioni është i obliguar të zbatojë itinerarin e ekskursionit të shkollës

- Itinerari i ekskursionit merret në DKA, dhe ofertuesi është i obliguar të zbatoj në përpikëri.
- Kriter për zgjedhjen e kompanisë, janë kushtet që i ofron kompania
- Ofertat dërgohen në DKA përmes zyrës së pranimit të KK Vushtrri
- Afati i ofertimit fillon nga data 04.09.2026 deri më datën 10.09.2026 ora 12⁰⁰
- Ofertat hapen më 10.09.2026 ora 14⁰⁰ në zyrat e DKA-së Vushtrri.

Naile Bekteshi
[Signature]
Drejtoreshë e DKA-së

